

Zhvillimi Makroekonomik i Ekonomise Shqiptare dhe Ridimensionimi i Saj

Elida Toli¹, Pranvera Mziu²

¹Departamenti Kolegji I Studimeve te Larta Profesionale, Kolegji Universitar I Biznesit

² Departamenti Kolegji I Studimeve te Larta Profesionale, Kolegji Universitar I Biznesit

*Corresponding Author: e-mail: etoli@kub.edu.al

Abstrakt

Ky raport synon të ofrojë një analizë të disa agregateve makroekonomik në Shqipëri, duke identifikuar sfidat kryesore dhe duke propozuar rekomandime për adresimin e tyre. Duke u bazuar në të dhënat dhe tendencat aktuale, do të analizohen çështjet kyçe si inflacioni dhe tendencat e tij, rrezikun e varfërisë dhe përjashtimit social, rritja e të ardhurave kombëtare, rritja ekonomike që përkthehet në rritje të punësimit, të pagave dhe PBB duke u bazuar fort tek zhvillimi i turizmit por edhe identifikimi i problematikave të tij si cilësia e shërbimeve, mungesa e fuqisë punëtore, problemet e transportit, rritja e nivelit të ndotjes si dhe ndryshimet ligjore të fundit që kanë ndikim në sektorin e turizmit, por jo vetëm, tek ekonomia e gjelbër që ndikon ekskluzivisht në rritjen ekonomike si edhe në rëndësinë e vlerësimit të ndikimit mjedisor të shkaktuar nga proceset e prodhimit të transformimit dhe përdorimit të lëndëve të para që synon rritjen e performancës ekonomike të një shoqërie nëpërmjet aplikimit të sistemeve të prodhimit me ndikim të reduktuar në mjedis.

Me rëndësinë e inovacioneve të reja në performacat mikro dhe makroekonomike të cilat kanë efekte të gjëra, duke ndikuar në rritjen e produktivitetit, punësimin, pagat, fitimet, pabarazinë e të ardhurave dhe mirëqenien, efekte që mund të ndryshojnë në sektorë të ndryshëm, dhe sipas niveleve të zhvillimit.

Megjithatë, duke pasur parasysh situatat rreth Evropës, Ballkanit Perëndimor dhe Shqipërisë, ka shumë për të pyetur se çfarë ka sjellëgjysma e pareë e çmund të sjellë viti 2025. Kompleksiteti i çështjeve dhe sfidave për të ardhmen është zvarritur nga viti i kaluar me dinamikë të paparashikueshme dhe shqetësime mbarëkombëtare.

Fjalët Kyçe: Rritje e ekonomike, Makroekonomik, Turizëm, Ekonomi e gjelbërt, Inovacion

Metodologjia

Studimi dhe analiza e treguesve makroekonomikë afatmesëm dhe i tërësisë së elementëve përbërës makroekonomik janë bazuar kryesisht në metodat modeluese dhe analitike të programimit financiar.

Analiza mbështetet në linjën aktuale të politikave makroekonomike, në linjën aktuale të politikave e reformave ekonomiko-strukturore qeveritare, në sjelljen dhe në bashkëveprimin racional të agjentëve ekonomikë në kontekstin e ambientit të brendshëm e të jashtëm

makroekonomik, i cili vlerësohet si më i mundshmi për periudhën afatmesme në vijim.

Janë përdorur të dhëna statistikore makroekonomike të gjeneruara prej institucioneve si INSTAT, BSH, MF, FMN, BB, Eurostat, etj.

Këto statistika janë përgjithsisht në formën e serive kohore me frekuencë vjetore, tremujore e mujore.

Indikatorët Makroekonomik

Ekonomia e vendit ka treguar një qëndrueshmëri dhe elasticitetit të konsiderueshëm përballë sfidave të njëpasnjëshme që kanë goditur vendin gjatë viteve të fundit. Kjo qëndrueshmëri është vënë në provë nga tre kriza madhore që ndodhën në mënyrë të njëpasnjëshme, si: tërmeti I viti 2019, pandemia globale e covid dhe ndërprerjet në furnizimin e mallrave bazë si pasojë e luftës në Ukrainë. Edhe pse me shumë sfida, kemi një rikthim të mirë ekonomik, dhe jemi drejt stabilitetit të përgjithshëm makroekonomik. Përballë një mjedisi ekonomik sfidues, të karakterizuar nga çmime relativisht të larta, pasiguri dhe kosto të larta financimi, Ekonomia ka ruajtur një normë të qëndrueshme rritjeje duke tejkaluar pritshmëritë fillestare. Performanca ekonomike gjatë kësaj periudhe ka qenë positive premtuese dhe pritët të vazhdojë ecurinë pozitive edhe në periudhën afatmesme.



1-RRITJA REALE E PBB

PBB nominale 2024 -18.9 miliardë dollarë ,PBB vjetor sipas Bankes Boterore.

PBB për frymë 2024- 8,562 USD krahasuar me mesataren globale prej 10,589 USD.

Rritja mesatare e PBB-së reale prej 3% gjatë dekadës së fundit.

Nga pikëpamja e ofertës agregate, sektorët të cilët kanë shënuar rritjen më të fortë përgjatë periudhës 9-mujore të viti 2024, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë janë: “Aktivitete profesionale dhe shërbime administrative” me rritje prej 10.77 përqind; “Administrimi publik, Arsimi dhe Shëndetësia” me rritje prej 8.88 përqind; “Ndërtimi” me rritje prej 8.11 përqind; “Tregti, Transport, Akomodimi dhe Shërbimi ushqimor” me rritje prej 6.13 përqind; “Aktivitete financiare dhe të sigurimit” me rritje prej 6.25 përqind, etj. Ndër sektorët që kanë pësuar rënie janë : “Industria” me rënie prej -6.86 përqind dhe “Bujqësia, pyjet dhe peshkimi” me rënie prej -0.84 përqind.



Rritja ne % e PBB se Rajonit

	Rritja e PBB ne %	2023	2024	2025(parashikimi)
1	Shqipëria	0.8	-0.1	-0.1
2	Bosnje dhe Hercegovina	-0.3	-0.2	-0.1
3	Kosova	-0.5	-0.5	-0.2
4	Maqedonia e Veriut	-0.6	-0.2	0.0
5	Mali i Zi	1.4	0.1	0.2
6	Serbia	-0.3	0.0	0.
	<i>Ballkani Perëndimor-6 vendet</i>	-0.1	-0.1	0.0

Rimëkëmbja dhe rikthimi në nivelet e parapandemisë shfaq dallime midis vendeve. Rritja ekonomike në Malin e Zi dhe Shqipëri që vitin 2023 është më e lartë sesa pritej, e nxitur, veç të tjerash edhe nga një sezon i suksesshëm turistik, mund të ngadalësohet pak për vitin 2024. Rritja në Serbi, Maqedoninë e Veriut, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kosovë u përshpejtuan në vitin 2024, e mbështetur nga rritja e konsumit dhe investimeve.

“Inkurajuese është se Ballkani Perëndimor vijon të shënojë progres në arritjen e ekonomive të përparuara të Bashkimit Evropian. Megjithatë, ritmet e konvergjencës ekonomike janë të ndryshme, dhe kjo kërkon reforma të shënjestruara për të konsoliduar rimëkëmbjen drejt rritjes së qëndrueshme”.

Përkundër të gjitha gjasave, tregu i punës në Ballkanin Perëndimor vijoi të forcohej edhe përgjatë vitit 2023. Shkalla mesatare e punësimit në rajon shënoi një nivel të ri të lartë historik duke arritur në pothuajse 48 përqind me 103,000 vende pune të reja të krijuara midis mesit të 2022 dhe mesit të 2023. Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina dhe Mali i Zi shënuan arritjet më të mëdha. Megjithatë, mungesa e fuqisë punëtore vijon të mbetet ndër shqetësimet kryesore të ngritura nga bizneset në Ballkanin Perëndimor. Pavarësisht vullit të përjetuar gjatë viteve të fundit të periudhës pas pandemisë, pjesëmarrja në forcën e punës mbetet e ulët dhe, së bashku me dallimet e mëdha gjinore, po kufizon uljen e mëtejshme të varfërisë.

Sipas raportit, rajoni duhet jo vetëm të adresojë barrierat ndaj pjesëmarrjes më të madhe në forcën e punës, por edhe të përshpejtojë konvergjencën ekonomike me ekonomitë më të përparuara të Europës. Këto përpjekje duhet të shoqërohen me tranzicion më të shpejtë drejt ekonomisë së gjelbër dhe më shumë investime për të rritur qëndrueshmërinë ndaj fatkeqësive natyrore, ndër të tjera edhe në bujqësi.

INDIKATORET E EKONOMISE SHQIPTARE:

Një ekonomi në rritje, por me një zhvillim të ngadaltë Shqipëria ka përjetuar rritje të qëndrueshme ekonomike gjatë dy dekadave të fundit në një ekonomi të bazuar në treg.

Rritja është nxitur nga sektorët :

- Ndërtimi,
- Turizmi dhe
- Remitancat.

Sektori i turizmit është bërë një kontribues i madh në ekonominë e Shqipërisë si në aspektin e të ardhurave që sjell në PBB por edhe të punësimit sezonal, zhvillimin e ekonomive locale nëpërmjet diversifikimit të produktit dhe bizneseve që ndihmojnë këtë sektor.

Megjithatë, ekonomia mbetet e pazhvilluar, me nivele të larta informaliteti dhe kapacitete të kufizuara. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) pret nga ekonomia e Shqipërisë të zgjerohet me 3.5% në 2025, gjë që përputhet me rimëkëmbjen e pritshme globale.

Gjatë vitit 2025, pritet që ekonomia shqiptare të rritet 3.8 për qind. Sipas parashikimeve të Komisionit Europian, pas një rënije të shpejtë në vitin 2024, inflacioni pritet të kthehet gradualisht në objektivin prej 3% të Bankës Qendrore vitin e ardhshëm.

Qeveria shqiptare e projektton rritjen ekonomike në 3.9%.

Megjithatë, rënia e produktivitetit, kryesisht për shkak të Rënies së popullsisë së Shqipërisë është tendenca më shqetësuese. Një fuqi e kufizuar punëtore do të duhet të mbështesë nevojat e veta si dhe rritjen e numrit të pensionistëve, duke vënë një tendosje shtesë në ekonomi. Për shkak të kësaj, një tendencë domethënëse tregon një ngadalësim të produktivitetit, si dhe burime të kufizuara mund të pengojë më tej rritjen. Investimet në 2024 u rritën më shpejt se në vitin 2023 dhe pritet të përshpejtohen në gjysmën e dytë të vitit 2025 për shkak të rritjes së shpenzimeve kapitale publike me një alokim prej 74 miliardë lek në projekte të mëdha në infrastrukturë si rruga Milot-Morinë, Orikum-Dukat dhe zgjerimi i rrjeteve energjetike.

Bumi turistik shtyu eksportet e shërbimeve, ndërsa eksportet e mallrave vazhduan të tkurren për shkak të uljes së kërkesës nga eurozona, rënie e çmimeve të lëndëve të para në tregjet ndërkombëtare dhe forcimi i kursit të këmbimit të lekut.

Komisioni Europian evidenton në raport se "Punësimi u rrit në vitin 2023 dhe pritet të rritet më tej gjatë viteve 2024-2026, megjithëse me një ritëm më të moderuar. Shkalla e papunësisë pritet të bjerë më tej. Pavarësisht përmirësimeve në tregun e punës, emigracioni mbetet një problem.

Konsumi Privat dhe investimet ishin nxitësit kryesorë të kërkesës.

Perspektiva ekonomike e Shqipërisë do të varet nga rimëkëmbja e ekonomisë globale dhe nga ritmi i vazhdimësisë së reformave. Varësia në rritje e Shqipërisë nga financimi i jashtëm, kursi i këmbimit, norma e interesit, dhe rreziqet e rifinancimit mbeten të larta. Shqipëria është shumë e ekspozuar nga goditjet e jashtme, të tilla si një recesion në BE ose shtrëngimi i mëtejshëm i kushteve të financimit në tregjet ndërkombëtare të kapitalit.

Agjencia ndërkombëtare e vlerësimit të kredisë Moody's ka rishikuar vlerësimin e saj, duke rritur atë të Shqipërisë, "perspektiva nga "B1-me një perspektivë pozitive" në "Ba3-të qëndrueshme".

Investimet e huaja direkte, veçanërisht në sektorët e turizmit dhe energjisë, pritet të luajnë një rol kyç në vitin 2025. Këto ndryshime pritet të përmirësojnë ekonominë duke e zhvendosur fuqinë punëtore nga bujqësia në sektorë më produktivë si turizmi.

RRITJA EKONOMIKE gjatë 2025 :

Sipas Komisionit Europian pritet që ekonomia shqiptare të rritet 3.8 % (raporti i fundit i KE ku janë marrë në shqyrtim vendet anëtare të BE-së, ato të eurozonës dhe vendet kandidatë).

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) pret nga ekonomia e Shqipërisë të zgjerohet me 3.5% në 2025.

Qeveria shqiptare e projektton rritjen ekonomike në 3.9%.

Pas recesionit të fortë prej -3.3 % në vitin 2020

Rritja ekonomike ishte rreth 3.9 % për vitin 2024 dhe

Rritja ekonomike parashikohet në normën 3.9 % për vitin 2025.

Po ashtu parashikohet

- 4.0 % për vitin 2026
- 3,9 % për vitin 2027
- 4.1 % për vitin 2028

PUNESIMI / PAPUNESIA

Komisioni Europian evidenton në raport se "Punësimi u rrit në vitin 2023 dhe pritet të rritet më tej gjatë viteve 2024-2026, megjithëse me një ritëm më të moderuar. Shkalla e papunësisë pritet të bjerë më tej. Pavarësisht përmirësimeve në tregun e punës, emigracioni mbetet një problem.

Sfidat e zhvillimit makroekonomik te 2025

Sfidat me të cilat përballet ekonomia në vitin 2025 përfshijnë disa çështje të trashëguara, si p.sh

1. Reformimi i skemës së pensioneve,
2. Lufta kundër informalitetit,
3. Ruajtja e stabilitetit të çmimeve,
4. Mbrojtja e mjedisit etj.

Skema e pensioneve prek rëndë financat publike, me 800 mijëpunonjës të siguruar dhe 725,000 pensionistë.

Raporti problematik ndërmjet kontribuesve dhe përfituesve nënvizon nevojën urgjente për të trajtuar nënvlerësimin e gjerë të pagave.

Ndërtimi dhe turizmi pritet të çojnë vitin 2025 në rritje ekonomike.

Sektori industrial po përjeton një zhvillim tkurrje të konsiderueshme në ekonominë ndërkombëtare dhe evropiane.

Një nga sektorët që përjeton zhvillim të qëndrueshëm është sektori i teknologjisë, veçanërisht inteligjenca artificiale dhe fusha teknologjike në përgjithësi. Për fat të keq, Shqipëria nuk është përfshirë sa duhet në këtë sektor, gjë që mund ti sjelli një përmirësim të ndjeshëm në cilësinë e produkteve dhe një rritje të prodhimit.

Sektori i ndërtimit pritet të rritet për shkak të fluksit të madh të parave dhe kërkesës së lartë për ndërtim, por ky sektor nuk siguron rritje të qëndrueshme afatgjatë.

Ndërtimi nuk përkthehet drejtpërdrejt në produkte të eksportueshme dhe vlera e tij varet nga çmimet e larta e tregut të pasurive, duke krijuar më shumë një fluks financiar brenda vendit sesa rritjen ekonomike të qëndrueshme.

Turizmi, ka një ndikim të kufizuar. Sjell të ardhura, prek vetëm segmente të caktuara, nuk garanton rritje të qëndrueshme për ekonominë

BUJQESIA

Bujqësia është një nga sektorët më të prekur nga thatësitat, ndryshimi i jetëgjatësisë së stinëve dhe kushtet e paparashikueshme të motit."Kjo kërkon përmirësim të politikave publike dhe investimeve për të nxitur përdorimin e gjerë të teknologjive dhe praktikave inteligjente për klimën nga fermerët të mbështetur nga institucione më të forta publike, të cilat janë thelbësore për rritjen e qëndrueshme bujqësore.

Ndërkohë që sektori i bujqësisë në rajon po tkurret, bujqësia e gjelbër ofron një mundësi për rritjen e produktivitetit, konkurrencës dhe qëndrueshmërisë së sektorit, përmes përdorimit efikas të fondeve publike në dispozicion, njohurive dhe inovacionit.

INOVACIONI

Inovacioni përgjithësisht konsiderohet si një shtytës kryesor i rritjes dhe performancës së përgjithshme ekonomike, megjithatë procesi i inovacionit zakonisht zhvillohet në nivelin e firmës ose sipërmarrësit individual, dhe shpesh me mbështetje dhe inpute nga sistemi më i gjerë i inovacionit. Inovacioni ka efekte të gjera në performancën makroekonomike, duke ndikuar në rritjen e produktivitetit, punësimin, pagat, fitimet, pabarazinë e të ardhurave dhe mirëqenien, ndër të tjera, efekte që mund të ndryshojnë në sektorë dhe vende, dhe sipas niveleve të zhvillimit. Për më tepër, procesi dhe ndikimet e inovacionit janë një nxitës dhe i nxitur nga ndryshimet më të thella strukturore brenda ekonomive, një vëzhgim që krijon një rol për politikën industriale në formësimin e performancës ekonomike. Hulumtimi mbi makroekonominë e inovacionit, ndryshimin strukturor dhe politikën industriale brenda njësisë thekson nxitësit kompleksë të inovacionit në nivel makro, ndërveprimet dhe efektet kthyesë ndërmjet inovacionit dhe ndryshimit strukturor, dhe ndikimet zhvillimore afatgjata të këtyre ndërveprimeve. Kërkimet në këtë fushë adoptojnë më tej një perspektivë globale, duke marrë parasysh ndërveprimet midis vendeve nëpërmjet flukseve të tregtisë, teknologjisë dhe investimeve.

Konkluzione

NXITJA E RITJES EKONOMIKE NË SHQIPËRI NË VITIN 2025

Qellimi i kësaj ekonomie është një rritje ekonomike sa më e qëndrueshme .Faktoret te cilët duhet të kontribuojnë në këtë rritje evidentohen si :

Impakti i I: “Përmirësimi i Investimeve dhe i Klimës së të bërit Biznes”

1. Rritja e Investimeve si një zonë me interesin e pozitës gjeografike , kostos së ulët të punës , përmirësimi i klimës së biznesit nëpërmjet të reformës në administrimin publik dhe reformës së taksimit në vecanti, burokracive dhe bandierave .
2. Rritja e transparencës dhe përmirësimi i digitalizimit të shërbimeve publike .
3. Edhe pse të Ardhurat promovohen si një qasje e re që favorizojnë stabilitetin e politikave tatimore dhe shmangieve të shpeshta të detyrimeve ligjore kanë treguar se nuk po ndodh ashtu sic është deklaruar nga administrata.
4. Promovimi i PPP (partneritet publik-privat) për projekte të mëdha infrastrukturore duket se janë me probleme të shumta .Konstatimet dhe rekomandimet në këtë aspekt tregojnë se duhet te adresohen drejt cilësisë,tipologjive diversive dhe jo vetëm drejt sasisë.
5. Financimi më i lehtë dhe më i lirë i NVM (Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme) shihet si masa e pare ne fillimet e 2025.
6. Qendrat mbështetëse për inovacion dhe eksporte duhet të transformojnë nismën e “Shtëpise së Biznesit
7. Duhet te dilet nga modeli i derisotëm nëpërmjet një skanimit të ndërgjegjshëm dhe te diskuteshëm me te gjithë aktorët e grupeve të interesit nëpërmjet te lehtësirave fiskale për sektorë strategjik si energjia,teknologjia,turizmi dhe bujqësia .

Impakti i 2: “Riformatimi i Nxitur nga Zhvillimi i Infrastrukturës së Nevojshme dhe Jo Ambicjeve Afatshkurtëra ”

Shqipëria ka përmirësime në rrugë, porte , aeroporte etj por ka akoma mangësi infrastrukturore në lidhjet rajonale dhe brenda vendit. Rritja e përmirësimit infrastrukturor bën të mundur një konkurrencë më të mirë dhelidhje më të shpejtë me tregjet rajonale dhe ndërkombëtare .

Ende infrastruktura është një barrë financiare e familjeve dhe bizneseve. Masat më të shpejta duhet të drejtohen drejt infrastrukturës digjitale(përmirësimi i aksesit në internet dhe zhvillimi i teknologjive të reja).

Edhe energjia e rinovueshme duhet të jetë ndikuese në ekonomi.Fokusi te teknologjia luan rol thelbësor tek modernizimi i ekonomisë, përmirësimin e shërbimeve dhe nxitjen e inovacionit.

Impakti i 3 : Diversifikimi i Ekonomisë

Promovimi i turizmit të qëndrueshëm është një nga qasjet.

Agrobiznesi dhe bujqësia është qasja e dytë,Investimet në teknologji për një bujqësi smart duhen për të rritur prodhimin dhe exportet e produkteve bujqësore.

Energjia e rinovueshme duhet të fokusohet në zhvillimin e energjive të pastra (diellore dhe te erës, gazi dhe biomasa etj). Për zhvillimet ndërsektoriale duhet të zhvillohen paketa teknologjike.

Impakti i 4: Burimet Njerzore

Fuqia punëtore në Shqipëri është relativisht e re , por i mungojnë aftësitë për sektorët me të shtuar të lartë.Për këte aftësimi profesional duhet te adresojë kurrikula në përshtatje me tregun e punës dhe trajnimi i forcave punonjëse për sektorët e rinj.

Impakti i 5: Promovimi i Stabilitetit Politik e Ligjor

Përqëndrimi eskuzivëtëm në reformën për drejtesi mund te shpërfillë reformat në administratën publike,polici , sistemin tatimor dhe sektorë te tjerë jetik.

Impakti i 6: Nxitja e Administratës Drejt Përbushjes së Detyrave për Integrimin European

Procesi i progresit drejt integritit në Bashkimin European mund të nxisë reforma strukturore dhe tërheqë investime nga vendet e BE.Mund të përshpejtoj reformën në fushën e tregëtisë,bujqësisë dhe arsimit.


INFLACIONI

Inflacioni global i vitit 2024 u stabilizua pa e prishur ekonominë globale.

Priten: nje 2025 domethënëse dhe plot ngjarje politike dhe ekonomike. ndërprerje të zhvillimeve të mëdha ekonomike, ringjallje e luftërave tregtare ,masat e mundshme shtrënguese dhe ndryshime të thella demografike që shoqërojnë një revolucion energjitik.

Këta faktorë janë vendimtar në formësimin e peizazhit ekonomik global në vitin 2025 por edhe nëShqipëri.

Këtë skenar, Shqipëria e ka nisur tashmë me disavantazh.



Rritja mesatare vjetore e çmimeve, e matur nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK), një metodologji kjo e Eurostat, në vitin 2024 është 2,6 %. Sipas raportit të publikuar nga INSTAT, inflacioni sipas metodës së Eurostat rezultoi 0,4 % më i lartë se sa ai i matur nga INSTAT.


Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) mat ndryshimin e nivelit të çmimeve me pakicë të mallrave dhe shërbimeve nga pikëpamja e strukturës së shpenzimeve të cilat konsumatori (vendas dhe i huaj) synojnë për konsumin final në territorin e Shqipërisë. IHÇK përdoret për monitorimin e lëvizjes së çmimeve me pakicë në vendet Evropiane, duke krahasuar përqindjen e inflacionit ndërmjet vendeve të Evropës dhe si inflacion zyrtar i Bankës Qendrore Evropiane duke siguruar stabilitetin e çmimeve në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar.

Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit në 2024, sipas INSTAT-it është 2,2 %.

Referuar raportit për IHÇK, rritja mesatare e çmimeve, e matur nga Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit për muajin dhjetor 2024 në krahasim me muajin nëntor është 2,4 %. Të dhënat tregojnë se rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “argëtim dhe kulturë” me 5,4 % , pasuar nga grupet “pije alkoolike dhe duhan” me 3,9 % , “mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje” me 3,6 % , apo “veshje dhe këpucë” me 3,2 %.

Çmimet e grupit “ushqime dhe pije joalkoolike” shënuan rritje vjetore prej 2,7 % , ato të grupit “shëndeti” me 1,5%, dhe “qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 0,9 %. Nga ana tjetër, çmimet e grupit “Transporti” u ulën me 1,4 %.

Rritja mesatare e çmimeve 2024



ANALIZA E INFLACIONIT 2024


Inflacioni u ul në 2024, rënie e qëndrueshme gjatë vitit. Çmimet në vitin 2024 nuk pësuan luhajtje të forta.

Treguesit flasin për një nivel mesatar inflacioni, 2.2% nga 4.8 që ishte në vitin 2023.

Sipas INSTAT inflacioni mesatar në ekonomi e mbylli vitin 2024 në nivel 2.2% në rënie të ndjeshme nga fundi i 2023 me 4.8 % dhe 6.7% në vitin 2022, kur shpërtheu kriza e çmimeve nga kaosi që prodhoi pushtimi i Ukrainës. Kjo rënie më shumë se sa pritshmritë për 2024 solli ndryshimin 2 herë të normës bazë të interesit në nivelin 2.7%. Këshilli mbikqyrës i BSh u shpreh se kushtet monetare aktuale janë të përshtatshme për kthimin e inflacionit objektiv gjatë vitit 2025.

Inflacioni bazë përjashton zakonisht ato produkte që kanë luhatshmëri të lartë, kryesisht ushqimore dhe energjitike, zakonisht me natyrë afatshkurtër. Pra rritja e inflacionit bazë në dhjetor është e lidhur përgjithësisht me produktet ushqimore dhe energjitike.

Inflacioni bazë lidhet gjithashtu edhe me presionet e brendshme inflacioniste që janë ndikuar vitet e fundit nga rritja e kostos të punës së bizneseve.



Burimi: INSTAT

NIVELI I VARFERISE

Ky përshkallëzim i luhatshëm i inflacionit në 3 vitet e fundit ka sjellë dhe pasojat e veta, të cilat reflektohen deri tek individit dhe familjet e tyre. Sipas statistikave të fundit (INSTAT) për matjen e të ardhurave dhe standardeve të jetesës, më shumë se një milionë shqiptarë (në një vend me 2.4 milionë banorë) vuajnë nga varfëria.

INSTAT ka matur varfërinë duke ndjekur metodologjinë e Eurostat-it përmes treguesit "Në rrezikun e varfërisë ose përjashtimit social (AROPE)" Ky tregues i referohet individëve në rrezik për të qenë të varfër, të privuar rëndë materialisht dhe socialisht ose që jetojnë në familje me intensitet të ulët punësimi.


Shqipëria kishte 42.1% të popullsisë së saj në varfëri të rëndë. Kjo varfëri që sjell pabarazi ekonomike dhe sociale si dhe emigracion ka ardhur si rrjedhojë e disa FAKTOREVE të caktuar:

- 1-Oasje e liberalizuar e ekonomisë pa vëmendjen e duhur ndaj mbrojtjes sociale
- 2-Dhurimi masiv i tokave publike në favor të turizmit
- 3-Kalimi i shërbimeve publike me koncesion te privati
- 4-Mungesa e strategjive për të krijuar vende pune të qëndrueshme
- 5-Programe sociale të fragmentuara

6-Korrupsioni

7-Orientimi i gabuar i investimeve në infrastruktura dhe turizem pa zhvilluar prodhimin dhe bujqësinë (kjo strategji në vend që të gjeneronte punësim, mirëqenie dhe reduktim të pabarazisë stimuloi valë emigracioni).

8-Boshllëk demografik dhe ekonomik (40% e popullsisë jeton jashtë që sjell nivelin më të madh të pensionistëve të punësuar në Evropë).



Këta qytetarë jetojnë në familje që nuk mund të përballojnë të paktën shtatë nga trembëdhjetë kategoritë e privimit (6 kategori që lidhen me privimin në nivel individual dhe shtatë kategori që lidhen me privimin në nivel familjar).

Në nivel familjar, vështirësi konsiderohen si vonesa në pagesën e kredisë apo qirasë për banesën kryesore, pamundësia për të përballuar shpenzimet e një pushimi vjetor njëjavor larg shtëpisë, një shpenzim financiar i paparashikuar prej rreth 300 euro, një vakt me mish në tre ditë etj.

Individët mund të konsiderohen "në vështirësi" nëse nuk kanë akses në internet, të zëvendësojnë rrobat e vjetra me rroba të reja, të shpenzojnë një shumë të vogël parash çdo javë për veten e tyre, etj. Kështu, Shqipëria ka një nga përqindjet më të larta të popullsisë në rrezik të varfërisë dhe privimit material në Evropë; Treguesit e Shqipërisë janë dukshëm më të lartë

sesa ato të vendeve të tjera fqinje të Ballkanit Perëndimor.

Mali i Zi ka 34.1% të popullsisë në rrezik të varfërisë, Maqedonia e Veriut 32,6% dhe Serbia 30%.

Megjithatë, në përgjithësi ekonomia duket e mirë kur "pamja më e madhe" analizohet në shifra.

Sipas Bankës Botërore, rritja ekonomike e Shqipërisë vitin e kaluar u ndikua kryesisht nga shërbimet dhe ndërtimi.

REKOMANDIME

Varfëria nuk është vetëm një problem ekonomik por një çështje drejtesie dhe dinjiteti njerzror. Zgjidhja varet nga bashkëpunimi midis qeverisë shoqërisë civile dhe komunitetit ndërkombëtar.

Modele të suksesshme

1-Shqipëria mund të orientojë të rinjtë drejt tregut të punës npm zhvillimit të programeve të

Trajnimit . (Koreja e Jugut ka zhvilluar arsimin profesional dhe teknologjik duke ulur varferinë ,

Gjermania ka mbështetur fuqizimin ekonomik të zonave rurale ,Estonia një nga vendet më transparente në boteëka reduktuar korrupsionin nrm shërbimeve digjitale e-Estonia shembull i marrë nga Shqipëria për shërbimet e-Albania,por ndryshe nga ne ,në e-Estonia qytetarët kanë akses në gjurmimin e cdo transaksioni apo vendimi administrativ,Finlanda nrm platformës “Open Finland”lejon qytetarët të ndjekin projektet e financura nga buxheti i shtetit për tu paraprire keqperdorimeve, Brazili krijoi Banken Kombetare të zhvillimit për financim të NVM për ulejn e papunësisë,Kosova krijoi fondin privat të pensioneve për të rritur besimin tek perfitimi i pensioneve ,Singapori ka luftuar korrupsionin nrm nje sistemi pagash konkurruese per zyrtarët publike duke stimuluar motivimin dhe ndershmërinë.

SEKTORI MËFITIMPRURËS TURIZMI

TURIZMI

Nëse sezoni i vitit 2024 u shoqërua me një numër të lartë vizitorësh, por edhe me shumë problematika të patrajtuara si :

1. KORRELACIONI MIDIS NUMRIT TË TURISTËVE DHE NUMRIT TË TË PUNËSUARËVE

Menaxhimi i fluksit turistik është një sfidë komplekse që përfshin koordinimin ndërmjet autoriteteve lokale dhe bizneseve, gjithashtu përmirësimin e infrastrukturës, rritjen e kapaciteteve, trajnimin e stafit dhe implementimin e teknologjive të reja .

Në një vend si Shqipëria ku turizmi është një sektor kyç për ekonominë dhe punësimin përshtatja e numrit të të punësuarëve me fluksin e turistëve duket se është kthyer në sfidë.

Në rastin e rritjes së numrit të turistëve, kërkesa për shërbime, si akomodimi, ushqimi, transporti, dhe argëtimi rritet ndjeshëm.Kjo është e detyrueshme për të përballuar kërkesën e rritur të shërbimeve.Një nga problematikat kryesore me të cilat përballet sektori i turizmit në Shqipëri është mungesa e korrelacionit midis numrit të turistëve dhe numrit të të punësuarve në këtë sektor.Ndërsa numri i turistëve po rritet ndjeshëm, numri i të punësuarve nuk po rritet në të njëjtën shkallë.

1.1 PËRBALLJA ME FLUKSIN TURISTIK

Turizmi në Shqipëri ka përjetuar një rritje të ndjeshme në vitet e fundit, duke e vendosur vendin si një destinacion të preferuar për vizitorët e huaj. Mbi 1.158.204 shtetas rezultojnë të kenë hyrë në Shqipëri gjatë muajit Janar të këtij viti(2025), sipas të dhënave më të fundit të INSTAT. Referuar këtyre statistikave, ky tregues ka pësuar një rritje me 12.4%, krahasuar me Janarin e vitit 2024(mbi 90%per arsye biznesi).

1.2 INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET

Infrastruktura është një komponent kyç për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm.Shqipëria ka nevojë për përmirësime të mëdha në infrastrukturën rrugore, të transportit dhe të akomodimit për të përballuar numrin e madh të turistëve që pritet të vizitojnë vendin në vitin 2025. Bumi turistik i shënuar gjatë sezonit veror të vitit të kaluar nxorri në pah jo pak problematika.:

1- shumë kompani nuk kanë arritur të sigurojnë hapësira akomoduese për shkak të mungesës së njësive akomoduese.

2-shfrytëzimi jo proporcional i vijës bregdetare. Disa pika janë të mbipopulluara ndërkohë shume zona potenciale mbeten të pa eksploruara .

3-Disproporcionaliteti midis shpërndarjes së zonave turistike duke e centralizuar vëmendjen ne 4-5 pika.

4- është i nevojshëm një rrjet më i mirë rrugor, sidomos në veri.

REKOMANDIME TURIZMI

Në kontekstin e vendeve fqinje, ka shembuj të praktikave të mira dhe zgjidhjeve të gjetura për të adresuar problematikat e infrastrukturës dhe shërbimeve. Për shembull, vendet e rajonit si Kroacia dhe Greqia kanë investuar në modernizimin e infrastrukturës së tyre në mënyrë të ndjeshme.

Kroacia, ka përmirësuar aeroportet dhe ka zhvilluar sisteme të avancuara të transportit publik për të lehtësuar lëvizjen e udhëtarëve, ka ndërtuar dhe rikonstruktuar hotele dhe struktura të tjera akomoduese për të përballuar kërkesën e rritur turistike.

Greqia, ka investuar në modernizimin e infrastrukturës rrugore dhe të transportit publik.

Turqia dhe Maqedonia kanë përdorur modelin e partneritetit publik-privat për të zhvilluar infrastrukturën.

Përveç infrastrukturës rrugore, është e nevojshme të përmirësohet edhe infrastruktura e akomodimit dhe e shërbimeve. Numri i hoteleve dhe i strukturave të tjera akomoduese duhet të rritet për të përballuar. Përveç infrastrukturës rrugore, është e nevojshme të përmirësohet edhe infrastruktura e akomodimit dhe e shërbimeve.

Në vitin 2024, 75% e hoteleve vuanin nga mungesa e punëtorëve, krizë e cila pritet ende të thellohet pasi numri i bizneseve është dyfishuar. Investimet në teknologji dhe inovacion mund të ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe në rritjen e eksperiencës pozitive të turistëve.

2. "LUFTA" ME MENAXHIMIN E MBETJEVE

Ministrja e Turizmit dhe Mjedisit thekson se lufta më e madhe në 2025 do të jetë me pastërtinë dhe menaxhimin e mbetjeve, një nga luftërat e pafituara. Kjo kërkon masa të menjëhershme për të përmirësuar menaxhimin e mbetjeve dhe për të siguruar një turizëm të qëndrueshëm. Autoritetet duhet të zhvillojnë strategji për reduktimin e mbetjeve, rritjen e riciklimit dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme në sektorin e turizmit.

Nga vende jo vetëm të Ballkanit, janë përdorur strategji të ndryshme të menaxhimit të mbeturinave dhe zhvillimin e praktikave të qëndrueshme për minimizimin e ndotjes. Disa nga shembujt janë:

1. Kroacia: Kroacia ka zhvilluar një program, duke vendosur kosha për mbetjet në vende të caktuara, duke organizuar fushata ndërgjegjësuese për të përdorur koshat e plehrave, dhe duke përdorur ekipe të posaçme për të pastruar plazhet në mënyrë të rregullt.

2. Greqia: Në Greqi, autoritetet kanë hartuar ligje dhe rregullore për të kufizuar përdorimin e plastikës dhe për të promovuar riciklimin.

3. Maqedonia e Veriut: ka investuar në infrastrukturë për trajtimin e mbetjeve dhe për të përmirësuar sistemin e riciklimit.

4. Mali i Zi: Mali i Zi ka ndërmarrë masa për të reduktuar përdorimin e plastikës në zonat bregdetare.


3- "RRUGËT E REJA, TUNELET DHE PORTET NDIKIM NË RITJEN E TURIZMIT"

Do adresohen gjatë 2025 projekte kryesore që do të ndihmojnë përsa i përket zhvillimit të turizmit, i cili lidhet drejtpërdrejt si me investimet në infrastrukturë, rrugë, aeroporte, porte edhe në struktura akomoduese më cilësore.

4- NDRYSHIMET LEGJISLATIVE LIDHUR ME LIGJIN PËR TURIZMIN.

Ligji Nr. 93/2015 për Turizmin, i ndryshuar me Ligjin Nr. 30/2024, ka për qëllim të rregullojë sektorin e turizmit në Shqipëri dhe të promovojë zhvillimin e tij në mënyrë të qëndrueshme. Megjithatë, disa aspekte të këtij ligji duket se krijojnë hapësira për diskutim për shkak të disproporcionalitetit të tatimeve dhe politikave të favorizimit të turizmit të qëndrueshëm.

Objekti i Shqipërisë, më 2025 numri i turistëve të shkojë në 12 milionë.



Burimi: INSTAT

BUXHETI I SHTETIT

GJITHSESI në Shqipëri duhet të konsiderojmë sektorë të tjerë më strategjikë dhe të qëndrueshëm, të tillë si teknologjia, për të arritur termi zhvillim i qëndrueshëm ekonomik.

Buxheti i Shtetit për vitin 2025, ku ndërthuren paraja dhe zgjedhjet:

Qeveria Shqiptare pret të mbledhë 7.5 miliardë euro në arkën e shtetit në vitin 2025 dhe të shpenzojë 8.2 miliardë shuma më e madhe në historinë shqiptare. Ky buxhet parashikon rritje ekonomike prej 3.9% ndërkohë shpenzimet do të rriten me afro 500 milionë euro. Në 2025 shpenzimet fokusohen në dixhitalizim, transport, siguri kombëtare, shëndetësi, arsim dhe bujqësia.

Dokumenti buxhetor vlerëson se stoku i borxhit publik do të arrijë në 13 miliardë euro me një trajektore rënëse në 55.8%, nga 56.3%. Buxheti përfshin edhe nxjerrjen e një Eurobond-i me vlerë 650 milionë euro, vazhdimi i procesit të rindërtimit pastërmetit të 2019 me financimin 50 milionë euro, shpërblim dhe indeksim për pensionistët për 50 milionë euro. Emetimi i Eurobond-it me vlerë 650 milionë euro qëdo mbështesë buxhetin është kritikuar sepse në fund të fundit është huamarrja për të paguar borxhin.

Indeksimi i pensioneve është mjaft i ulet, duke pasur parasysh se pensioni mesatar në Shqipëri është 140-150-euro në muaj. Megjithatë, ajo që është më shqetësuese është vëmendja (financimi) i shtuar ndaj bashkive të cilat do të marrin 890 milionë euro, ndërsa numri i punonjësve në administratë do të rritet. Rreth 160-180 mijë njerëz janë vlerësuar si punonjës të shtetit në Shqipëri ndërmjet autoriteteve qendrore (86 mijë), pushtetit vendor (37 mijë), dhe agjencitë shtetërore për pjesën tjetër. Që nga viti 2024, ata janë paguar më shumë se ata në sektorin privat.

Referencat:

1. https://china-cee.eu/137p-content/uploads/2025/03/2025p01_Albania.pdf
2. <file:///C:/Users/user/Downloads/Kuadri-Makroekonomik-dhe-Fiskal-per-periudhen-2026-2028-VKM-Nr-83-date-5.2.2025-1-1.pdf>
3. <file:///C:/Users/user/Downloads/Kuadri-Makroekonomik-dhe-Fiskal-per-periudhen-2026-2028-VKM-Nr-83-date-5.2.2025-1-2.pdf>
4. <https://financa.gov.al/137p-content/uploads/2024/05/Treguesit-Kryesore-Makroekonomik-2023.pdf>
5. <https://monitor.al/inflacioni-baze-u-rrit-ne-dhjetor-arriti-nivelin-me-te-larte-ne-shtate-muajt-e-fundit/>
6. <https://137137137.focus-economics.com/countries/albani>
7. OraNews (2024, May 14). EBRD keeps Albania's economic growth unchanged for 2024, at 3.3%. <https://www.oranews.tv/ekonomi/berzh-mban-te-pandryshuar-rritjen-ekonomike-te-shqiperise-per-vitin-2024-i1160208>
8. Rritja ekonomike, 3.8% Raporti i BE për Shqipërinë: U rrit prodhimi, konsumi, pagat dhe punësimi <https://top-channel.tv/2024/11/16/rritja-ekonomike-3-8-raporti-i-be-per-shqiperine-u-rrit-prodhimi-konsumi-pagat-dhe-punesimi/>
9. Ministry of Finance of the Republic of Albania (2024, November 4). Minister Malaj presents the 2025 draft budget <https://financa.gov.al/ne137sroom/ministri-malaj-prezanton-projektbuxhetin-2025-ne-komisionin-parla>
10. <https://top-channel.tv/2024/11/16/rritja-ekonomike-3-8-raporti-i-be-per-shqiperine-u-rrit-prodhimi-konsumi-pagat-dhe-punesimi/ustriale>.
11. <https://www.worldbank.org/en/neës/press-release/2024/10/17/albania-s-economic-growth-stays-strong-and-projected-to-moderately-accelerate-in-2025>
12. AIDA, Albanian Investment Development Agency (2024, November 5). The Albanian economy continues to strengthen. <https://aida.gov.al/ekonomia-shqiptare-vijon-te-forcohet/>
13. OraNe137s (2024, May 14). EBRD keeps Albania's economic growth unchanged for 2024, at 3.3%. <https://www.oranews.tv/ekonomi/berzh-mban-te-pandryshuar-rritjen-ekonomike-te-shqiperise-per-vitin-2024-i1160208>
14. Top-channel Rritja ekonomike, 3.8%/ Raporti i BE për Shqipërinë: U rrit prodhimi, konsumi, pagat dhe punësimi <https://top-channel.tv/2024/11/16/rritja-ekonomike-3-8-raporti-i-be-per-shqiperine-u-rrit-prodhimi-konsumi-pagat-dhe-punesimi>
15. Scan (2025, January 2). Economy 2025, growth expectations in an election year – Underdeclaration of Wages and informality, challenges that need to be faced. <https://scantv.al/lajme/shqiperia/ekonomia-2025-pritshmerite-e-rritjes-ne-nje-vit-zgjedor-nendekl-i20924>
16. Ibid.
17. <https://altax.al/en/Ëhat-can-boost-economic-growth-in-albania-by-2025/>
18. https://china-cee.eu/Ëp-content/uploads/2025/03/2025p01_Albania.pdf

19. <https://ata.gov.al/2025/01/18/inflacioni-sipas-metodologjise-se-eurostat-26-ne-2024-en>
20. <https://ata.gov.al/2025/01/18/inflacioni-sipas-metodologjise-se-eurostat-26-ne-2024-en/>
21. <https://monitor.al/varferia-ne-shqiperi-nje-plage-e-hapur-qe-kerkon-nderhyrje-urgjente/>
22. <https://monitor.al/varferia-ne-shqiperi-nje-plage-e-hapur-qe-kerkon-nderhyrje-urgjente/>
23. A2CNN (2024, October 28). The largest in history! The state budget for 2025 will be 8.2 billion euros.
<https://a2ne137s.com/shqiperia/ekonomi/me-i-madhi-ne-histori-buxheti-i-shtetit-per-vitin-2025-do-te-jet-1131246>
24. Euronews Albania (2024, October 10). The budget for 2025 will be 8.2 billion euros: Debt decreases, administration increases.
<https://eurone137s.al/buxheti-per-2025-en-do-te-jete-8-2-miliarde-euro-ulet-borxhi-shtetit-administrata/>
25. https://china-cee.eu/wp-content/uploads/2025/03/2025p01_Albania.pdf